



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 7016

NR. VENDIMI 10236

V E N D I M
" NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata e Rrethit Gjyqësore Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

Rezarta MATAJ ----- *Gjyqtare*

me sekretare seanceIna Serjanaj, në Tiranë, sot më datë **16 Dhjetor 2016, ora 09:00**, pasi mori në shqyrtim në disa seanca të veprimeve përgatitore me dyer të hapura çështjen civile që i përket :

Paditës:

Shoqëria "****" shpk me NUIS *** me adresë në *** me administrator ***, i cili përfaqësohet në gjykim me autorizim nga av. ***, antarë e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

I paditur:

Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave e përfaqësuar nga *** me delegim edhe Avokaturën e Shtetit Zyrën Vendore Tiranë,

Me person të tretë:

Shoqëria «***» spa e regjistruar në *** itali, e përfaqësuar dhe mbrojtur në gjykim e zgjedhur me prokurë të posaçme noteriale nga përfaqësuesi i autorizuar, av. *** antare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Me objekt:

1. Shfuqizimi i aktit administrativ Vendim Bordit te Apelimit te DPPM nr. *** Prot. Date 01/ 12/ 2015
2. Detyrimin e pales se paditur Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markaveper vazhdimin e procedurave per regjistrimin e markes me nr. Aplikimi kombetar *** me aplikant shoqerine "****" shpk.
3. Detyrimin e pales se paditur Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave te kryej publikimin perkatese ne Buletinin e Pronesise industriale.

Baza ligjore:

Neni 142, 143, 144, 152, 153, 156, 173 të ligjit nr. 9947 datë 07 korrik2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar.

-Nëbisedimet përfundimtare pala paditëse kërkoi: "Pranimin e kërkesë padisë, sipas objektit".

-Pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe e Patentave dhe personi i tretë u shprehën: "Rrëzimin e padisë".

-Gjykata pasi mbylli hetimin gjyqësori, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brëndshme

VËREJËN se

1. Paditësi Shoqëria "****" shpk i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë – padinë objekt gjykimi. Kjo e fundit me vendimin nt. *** datë *** ka deklaruar moskompetencën lëndore të çështjes dhe kalimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej GJRRGJ Tiranë).

2. Gjykata sipas nenit 348 të Kodit të Proçedurës Civile (më tej KPRC) vlerëson se ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën tokësore dhe lëndore në gjykimin e kësaj kërkesë-padie pasi është seksioni tregtar i kësaj Gjykate e cila gjykon të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale për tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.1 Ky qëndrim është i konsoliduar edhe nga praktika e Gjykatës së Lartë e cila pavarësisht se diskutohet për ankimim të vendimit të Drejtorisë së përgjithshme të Markave dhe Patentave (organ administrativ), duke qënë se kemi të bëjme me lënde të fushës tregtare si ajo e pronësisë intelektuale, parashikohet të gjykohet vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Sipas nenit 35 të KPRC kjo çështje gjykohet nga një gjyqtar pasi vlera e objektit të padisë është nën 20 milion lekë.

II. Mbi faktet dhe rrethanat e çështjes të provuara në gjykim

4. Paditësi është krijuar si shoqëri tregtare me datë 15 gusht 2006. Ka fushë të veprimtarisë së saj tregti me shumicë e pakicë artikuj ushqimorë dhe industriale, transport mallrash etj. tregtim me shumicë e pakicë, marketing etj.

4.1 Me datë 14 nëntor 2013 kërkuesi me aplikimin *** kërkon që të regjistroj markën me fjalë Tropikal LEMON SODA dhe me figurë me dy limona, gjethe dhe me shiritë, sfond i zi dhe kombimin me ngjyrë të verdhë, portokalli, jeshile, e kuqe, e bardhe, e zeze (shih më poshtë tabelën e të dy markave që pretendohen) me klasifikim të mallit sipas Konventës së Nicës, nr. 32, pije joalkolike.

5. Personi i tretë ***, është shoqëri e të drejtës italiane e cila prodhon dhe tregton pije alkolike dhe jo alkoolike. Për këto pije personi i tretë ka regjistruar me datë 25 nëntor 2009, me nr. *** (me kohë fillimi mbrojtje që me 09 prill 2009) markën tregtare vetëm emrin "LEMON SODA" e shkruar me dizeno e zezë, e bardhë, e verdhë, gjelbër për klasën nr. 512 të Klasifikimit të Konventës së Nicës ku përfshihen: birra, ujra, miera dhe të gazuar dhe pije të tjera jo-alkoolike, pije frutash dhe shurube, preparate të tjera për ërjen e pijeve në klasën 32. Afati i mbrojtjes së kësaj marke është 09 prill 2019.

6. Më pas me datë 30 korrik 2012 është bërë aplikimi nr. *** për të dyja emër dhe figurë në emër të personit të tretë: LEMON SODA dhe me ngjyra E zezë, e bardhë, e verdhë e gjelbër, e stilizuar sipas klasifikimit të Konventës së Vienës gjethe, limona të mbivendosur për mallrat sipas klasifikimit të Nicës nr. 512 si birrë, ujra mineralë dhe të gazuar dhe pije joalkoolike, pije frutash, lëngje frutash, shurupë, produkte të tjera për përgatitjen e pijeve. Kjo markë tregtare ka mbrojtje deri me datë 30 korrik 2022. Emri i personit të autorizuar në Shqipëri është ***.

6.1 Me datë 03 korrik 2014, ***, si pronare e markës me nr. *** e vitit 2009 dhe markës me nr. *** e vitit 2012 (shih më poshtë tabelën) ka paraqitur kërkesë për të kundërshtuar aplikimin e datës 09 prill 2014 të *** Shpk për tu mos u regjistruar kjo masë pasi marka është identike dhe ka ngjashmëri duke shkaktuar konfuzion tek konsumatori.

7. Bordi i apelimit me vendimin e datës 01 dhjetor 2015 ka pranuar këtë kundërshtim duke analizuar se: *”marka e kundërshtuar kërkon mbrojtje për të njëjtat mallra për të cilët është mbrojtur marka e mëparshme si dhe shkalla e lartë e ngjashmërisë mes tyre, e përforcojnë rrezikun e shkatimit të konfuzionit të konsumatorit, përfshirë edhe mundësinë e bashkëlidhjes së tyre”*.

8. Me datë 05 janar 2016, *** shpk kërkon të shfuqizohet ky vendimi i DPPM, Bordi i Apelimit dhe të vazhdohet me regjistrimin e markës me nr. Aplikimi *** me aplikant shoqerine "****" shpk.

9. **Paditësi** pretendoi se mes të dy markave në të ardhem do të ketë ngjashmëri të ulët si në atë fonetik pasi vetëm Tropikal do të ketë mbrojtje ndërsa LEMON SODA nuk përfshihet në mbrojtje, logo është dy limona dhe gjethja e limonit ndërsa marka Tropikal LEMON SODA është një shenjë kompeleke me dizeno tepër të dallueshme. Po ashtu ka edhe marka tregtare me fjalën Cola dhe janë rregjistruar si Fresh Cola, Pepsi Cola, Coca Cola etj.

10. **Pala e paditur** u shpreh se ka ngjashmëri fonetike, konceptuale, mallrat klasës nr. 32 që ato mbrojnë pranadji kërkohet lënia në fuqi e vendimit të bordit të apelimit.

11. **Personi i tretë** u shpreh se Lemon Soda është një markë e mirnjohur e për këtë duhet të zbatohet neni 4/4/a i Direktivës 2008/95/EC të parlamentit Evropian dhe Këshillit. Marka LEMON SODA fjalë dhe etiketë janë regjistruar repsektivisht me nr. *** dhe *** për klasifikimin e klasës nr. 32. Të tre aspektet themelre të krahasimit të markave tregtare pamje, fonetike dhe konceptuale janë të njëjta. Legjislacioni nuk e njeh konceptin e markave derivuese apo dytësore siç pretendon pala paditëse nga ku rrjedh marka Tropical edhe ajo LEMON SODA, madje ajo është shumë pak e dallueshme nga emërtimi LEMON SODA tek marka e pretenduar e paditësit.

III. Legjislacioni izbatueshëm

12. Ligji 9947 datë 07 korrik 2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar
PJESA IV -MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT
KREU XXIII - KUSHTET DHE E DREJTA PËR MBROJTJEN

Neni 140 “Shenjat që përbëjnë markë “

“1. Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben

për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

Mund të përbëjnë markë shenjat e mëposhtme:

fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto. “

Neni 141 -Karakteri dallues

“Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre.

Karakteri dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t'i dallojë. “

Neni 142 - Refuzimi për shkaqe absolute

“1. Një shenjë nuk regjistrohet si markë nëse:

a) nuk ka karakter dallues;

b) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave apo të kryerjes së shërbimeve, ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave apo të shërbimeve;

c) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që janë bërë të zakonshëm në gjuhën e përditshme apo që janë kthyer në praktika tregtare;

ç) përbëhet nga forma ose vija, të imponuara nga vetë natyra e mallrave apo e shërbimeve dhe/ose forma apo linja thelbësore, për të përmbushur një rezultat teknik;

d) përbëhet nga forma, që u japin mallrave një vlerë thelbësore;

dh) përbëhet nga elemente, që cenojnë interesin publik ose që bien në kundërshtim me vlerat morale apo rendin publik;

e) përbëhet nga elemente, që kanë prirje të çorientojnë publikun për natyrën, cilësinë, origjinën gjeografike të mallrave dhe/ose shërbimeve, që ato kanë për qëllim të dallojnë;

ë) përbëhet nga tregues gjeografikë, për verërat ose pijet alkoolike, që nuk e kanë origjinën gjeografike nga vendet, që tregohen në këta tregues, edhe nëse tregohet origjina e vërtetë e produkteve, ose treguesit gjeografikë janë përkthyer apo shoqëruar me shprehje të tilla, si “lloji” “tipi” “stili” “imitimi” ose shprehje të ngjashme;

g) përbëhet nga: i) emra shtetesh (të plotë ose të shkurtuar); ii) emblema shtetërore, medalje, urdhra nderi; iii) vula dhe shenja zyrtare të miratuara

- nga vendi; iv) emblemat e organizatave të njohura ndërkombëtare ose shkurtimet e tyre; v) simbolet fetare; vi) flamujt kombëtarë;
- gj) përbëhet nga elemente, që bien në kundërshtim me nenin 6 të Konventës së Parisit, përveç kur autoritetet kompetente kanë autorizuar përdorimin e tyre.
- h) nuk përbën markë, sipas nenit 140 të këtij ligji;
- i) përmban ose përbëhet nga një emërtim origjine ose një tregues gjeografik, me efekt në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse kërkesa për regjistrimin e markës është dorëzuar pas datës së dorëzimit të kërkesës për regjistrimin e emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik dhe me qëllim mbrojtjen e tyre, të parashikuar në legjislacionin, në bazë të të cilit janë regjistruar ato dhe që kanë lidhje me të njëjtin lloj produktesh.
2. Një shenjë nuk përjashtohet nga regjistrimi si markë, në përputhje me shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni, në qoftë se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues në procesin e përdorimit përpara datës së aplikimit. “

Neni 143 -Refuzimi për shkaqe relative

“Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

1. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:
- a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;
- b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;
- c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t'u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.
3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:
- a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;
- b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;
- c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;
- ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit. “

IV. Vlerësimi dhe analiza e çështjes sipas ligjit dhe provave

13. Që një markë të regjistrohet dhe të gjej mbrojtje pronari i tij për të gjitha të drejta e pronësisë mbi të sipas të drejtës së pronësisë intelektuale, ligjit nr. 9947/2008 por edhe Konventës së Parisit duhet që:

- marka tregtare të përbëhet nga shenja/at të cilët janë të mundshme për tu paraqitur grafikisht;
- të ketë karakter identifikues, dallues të atij mallit dhe/ose shërbimit që tregon pronari i ardhëshëm, person fizik ose juridik. Dallimi duhet të jetë i tillë që të mos konfondohet nga çdo individ me intelekt mesatar, konsumator i zakonshëm. Dallueshmëria lidhet edhe me origjinën tregtare të mallit por edhe mallin a shërbimin që kërkon të dalloj.
- Të plotësoj kushtet e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji.
 - Neni 141 -Karakter i dallues;
 - Të mos ketë shkaqe absolute refuzimi, kjo bën që të verifikohen kryesisht si nga aplikuesi por edhe nga autoriteti që regjistron kryesisht sipas nenit 142 të ligjit;
 - Të mos ketë shkaqe relative refuzimi që nënkupton se edhe nëse është regjistruar marka ajo mund të shfuqizohet për raste përkatëse të nenit 143 të ligjit.

14. Në rastin konkret, rezulton se paditësi pretendon të regjistroj pronësinë në kombinimin e ngjyrave dhe të shkronjave: “Tropikal LEMON SODA” dhe me figurë dy limona njëri gjysëm i prerë, tjetri mbrapa tij i plotë, i vendosur me pamje nga e djathta dhe me gjethe në të, me katër ngjyra të kombinuara: e zezë, e verdhe, jeshile dhe portokalli. Malli që identifikon është pije e gazuar me shije limoni.

15. Në mënyrë krahasimore i paraqesim aplikimin dhe markën e regjistruar:

DETAJET E APLIKIMIT	
DETAJET E MARKES SË	

REGJISTR.

(210) Nr. i kërkeses:

Tipi i aplikimit:

Goods and Services mark

Lloji i markes:

Fjale dhe Figure

(540) Marka:

(591) Ngjyrat që Mbrohen:

portokalli, jeshile, e kuqe, e bardhe, e zeze

(531) Klasifikimi i Vienës:

5.7.12 - Lemons

26.11.13 - *Ėavy lines or bands, zigzag lines or bands

27.5.9 - *Series of letters presenting different forms of ėriting

29.1.14 - Four colours

(511) Lista e mallrave dhe/ose shĕrbimeve:

32 - pije frutash dhe lĕng frutash; shurupe dhe gatitje te tjera pĕr prodhimin e pijeve freskuese; Ujĕrat minerale dhe tĕ gazuara si dhe pijet e tjera joalkoolike;

(732) Pronari:

Emri

Adresa

Shteti

*******AL**

Dt.depozitimit:

14.11.2013

(210) Nr. i kërkeses:

Tipi i aplikimit:

Goods mark

Lloji i markes:

Fjale dhe Figure

(540) Marka:

(591) Ngjyrat që Mbrohen:

e zeze; e bardhe; e verdhe; e gjelber.

(531) Klasifikimi i Vienës:

*5.3.13 - *Stylized leaves*

5.7.12 - Lemons

*26.4.24 - *Quadrilaterals ëith dark surfaces or parts of surfaces*

*27.5.8 - *Letters linked to a figurative element*

29.1.14 - Four colours

(511) Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve:

32 - Birrë; ujra mineralë dhe të gazuar dhe pije të tjera joalkoolike; pije frutash dhe lengje frutash; shurupë dhe produkte të tjera për përgatitjen e pijeve.

(732) Pronari:

Emri

Adresa

Shteti

Dt.depozitimit:
30.07.2012

Statusi:
E regjistruar

Nr.regjistrimit:
14716

Dt.regjistrimit:
02.04.2013

(220) Data e depozitimit:
30.07.2012

(180) Data e mbarimit te mbrojtjes:
30.07.2022

(740) Perfaqësuesi i Autorizuar:
Emri
Adresa
Shteti
**** AL*
ETAJET E APLIKIMIT

**DETAJET E APLIKIMIT*
DETAJET E MARKES SË
REGJISTR.

(210) Nr. i kërkeses:

Tipi i aplikimit:
Goods and Services mark

Lloji i markes:
Fjale dhe Figure

(540) Marka:

*(591) Ngjyrat që Mbrohen:
portokalli, jeshile, e kuqe, e
bardhe, e zeze*

(531) Klasifikimi i Vienës:

5.7.12 - Lemons

*26.11.13 - *Éavy lines or bands,
zigzag lines or bands*

*27.5.9 - *Series of letters
presenting different forms of
ëriting*

29.1.14 - Four colours

*(511) Lista e mallrave dhe/ose
shërbimeve:*

*32 - pije frutash dhe lëng frutash;
shurupe dhe gatitje te tjera për
prodhimin e pijeve freskuese;
Ujërat minerale dhe të gazuara si
dhe pijet e tjera joalkoolike;*

(732) Pronari:

Emri

Adresa

Shteti

**** Shpk*

Dt.depozitimit:

14.11.2013

(210) Nr. i kërkeses:

Tipi i aplikimit:

Goods mark

Lloji i markes:

Fjale dhe Figure

(540) Marka:

*(591) Ngjyrat që Mbrohen:
e zeze; e bardhe; e verdhe; e
gjelber.*

(531) Klasifikimi i Vienës:

*5.3.13 - *Stylized leaves*

5.7.12 - Lemons

*26.4.24 - *Quadrilaterals ëith dark
surfaces or parts of surfaces*

*27.5.8 - *Letters linked to a
figurative element*

29.1.14 - Four colours

*(511) Lista e mallrave dhe/ose
shërbimeve:*

*32 - Birrë; ujra mineralë dhe të
gazuar dhe pije të tjera joalkoolike;
pije frutash dhe lengje frutash;
shurupë dhe produkte të tjera për
përgatitjen e pijeve.*

(732) Pronari:

Emri

Adresa

Shteti

Dt.depozitimit:

30.07.2012

Statusi:

E regjistruar

Nr.regjistrimit:

<p><i>Dt.regjistrimit:</i> 02.04.2013</p> <p><i>(220) Data e depozitimit:</i> 30.07.2012</p> <p><i>(180) Data e mbarimit te mbrojtjes:</i> 30.07.2022</p> <p><i>(740) Perfaqësuesi i Autorizuar:</i> Emri Adresa Shteti *** **ETAJET E APLIKIMIT</p>	
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

14. Gjykata konstaton se në tre aspektet fonetik, pamor dhe koncetuar por edhe funksional (qëllimin për të cilën ajo krijohet për të identifikuar një mall a shërbim të klasës së kategorizuar nga Konventa e Nicës) vërehet se marka e pretenduar Tropikal LEMON SODA ka një ngjashmëri afër identikes me markën e regjistruar të “LEMON SODA” të personit të tretë ***.

15. **Së pari-** Nga pikëpamja fonetike nga tre fjalë dy prej së cilës janë të markës së regjistruar. Pra fjalët si shenjë nuk e bëjnë të dallueshme këtë markë potenciale nga marka e regjistruar LEMON SODA. Madje ashtu siç e ka paraqitur fjalën tropical pak e dallueshme është nga syri i konsumatorit dhe më e lexueshme janë fjalët LEMON SODA.

16. **Së dyti-** nga pikëpamja vizuale, marka që pretendohet nuk është aspak e dallueshme. Kemi kombinim të të njëjtave ngjyra konkretisht katër ngjyrat e markës së regjistruar: e zezë, jeshile, e verdhë dhe e bardhë janë të përshtirë edhe në markën potenciale të paditësit: e zezë, e verdhë, e bardhë, jeshile veçse ka shtuar portokallin tek fjala “Tropical”.

16.1 Po ashtu elementët që përdor janë përsëri limon, gjethe, të vendosura në qendër, sipër tyre është fjala LEMON SODA me të mëdha njësoj si marka e regjistruar duke e bërë që të mos dallohet nga një konsumator i zakonshëm dhe me kujdes mesatar për të identifikuar mallin. Elementet dallues të markës së regjistruar LEMON SODA , emiri figura etj. janë përdorur në mënyrë tepër të ngjashme afër identikes nga ana e paditësit, ndërsa detajet shtesë janë aq të vogla dhe periferike sa janë të padukshme për çdo konsumator që i kushton pak minuta në zgjedhjen e mallit. Sapo çdo person të shikoj një pije me markën LEMON SODA me dy limona, sfond të zi e konfondon me markën e mëparshme duke i krijuar një konkurrencë të pandershme personit të tretë.

17. **Së katërti-** nga pikëpamja funksionale, malli që identifikon marka që kërkohet të regjistrohet është identike me mallin që identifikon marka e regjistruar LEMON SODA e personit të tretë, në klasifikimin e Nicës, nr. 32, pije freskuese.

18. Si përfundim, gjykata çmon se marka tregtare e aplikuar nga ana e *** shpk është tepër e ngjashmë në kufijtë e identikes me markën tregtare të perosnit të tretë *** me afat mbrojtje deri në 2019. Për këtë arsye dhe referuar nenit 143§1 shkronja "b" e ligjit të posaçëm duke qënë se ajo nuk dallon asnjë mall a shërbim në mënyrë të veçantë nga marka e personit të tretë, ka shkaqe relative për tu refuzuar regjistrimi i saj, prandaj me të drejtë Bordi i Apelimit të DPPM e ka pranuar kundërshtimin e regjistrimit dhe ka ndërprerë procedurën e mëtejshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126,306 -310 ,102-106 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenet 140 e vijues të ligjit nr. 9947/2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar

V E N D O S I

1. Rrëzimin e padisë së paditësit Shoqëria "****" sh.p.k., si e pambështetur në ligj dhe në prova.
2. Lënien në fuqi të vendimit të palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e markes me nr. Aplikimi kombëtar *** me kërkues paditësin "****" shpk.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse, ku bashkangjitur edhe urdhëri i ekzekutimit për shpenzimet gjyqësore të kryera nga pala e paditur.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga ne sërmyja e shpalljes së këtij vendimi. Për Avokaturën e Shtetit Zyra Vendore Tiranë ky afat fillon nga e nesërmyja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me date 16 dhjetor 2016 ora 09:30 !

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

Ina Serjanaj

Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORE
(Sipas neneve 102 dhe 106 të K. Pr. Civile)

Taksë regjistrimi	*** Lekë
Taksë aktesh noteriale	*** Lekë
Për njoftime	*** Lekë

TOTALI i SHPENZIMEVE: * Lekë**

Sekretarja Gjyqësore

Ina Serjanaj